



DËGJONI DHE MBËSHTESNI

UDHËZUES PËR PRINDËRIT DHE KUJDESTARËT RRETH EDUKIMIT SEKSUAL TË FËMIJËVE

Ky material ju drejtohet posaçërisht juve, si prind/kujdestar ligjor i një fëmije 5-11 vjeç. Duke e lexuar atë, do të mësoni për edukimin seksual të fëmijëve, do të kuptoni qëllimin e tij dhe do të zbuloni mënyra për të mbështetur fëmijën tuaj përmes diskutimeve të hapura dhe të informuara. Ju gjithashtu do të mësoni se çfarë është abuzimi seksual i fëmijëve në internet dhe si mund të parandalohet, p.sh., duke edukuar fëmijën tuaj për sigurinë dhe kufijtë.

Terminologjia

Abuzimi seksual i fëmijëve:

Çdo veprim, nga një i rritur ose një person dukshëm më i madh se fëmija, që cënon të drejtën e fëmijës për vetëvendosje seksuale ose çdo përpjekje për një veprim të tillë. Abuzimi seksual i fëmijëve përfshin pjesmarrjen në aktivitete seksuale me një fëmijë, detyrimin e një fëmije të shohë aktivitet seksual ose abuzim seksual, dhe imponimin, detyrimin me force apo kërcënimin e një fëmije për tu përfshirë në aktivitete seksuale me një palë të tretë.

Materiale të abuzimit seksual të fëmijëve:

Çdo material foto/video që paraqet një fëmijë të përfshirë në sjellje seksuale (me ose pa një të rritur) dhe material me fokus në zonat gjenitale/anale të fëmijës.

Është mire të dimë!

Qëllimi kryesor i edukimit seksual nuk është të përgatisë një fëmijë për aktivitetin seksual, por të japë njohuri për emocionet, kufijtë, të drejtat seksuale dhe identitetin ndër të tjera. Edukimi seksual forcon ndjenjën e vetëvlerësimit të fëmijës dhe rrit njohuritë e tyre për veten. Vetëvlerësimi i lartë dhe ndjenja e fortë e identitetit janë bazat e një rritjeje pozitive. Kur një fëmijë e njeh veten dhe e konsideron veten të vlefshëm, ai mund të zhvillojë seksualitetin në mënyrë të sigurt dhe pozitive.

Grooming (krijimi i afrimitetit manipulues me fëmijën):

Një i rritur që krijon afrimitet me një fëmije në internet ose ne jeten reale, me qëllim abuzimin seksual të fëmijës. Ai mund të përfshijë rastet si më poshtë (Shënim! Të gjitha këto konsiderohen gjithashtu abuzim seksual i fëmijëve)

- komunikimi me një fëmijë në mënyrë seksuale
- komentimi i imazhit ose trupit të fëmijës me konotacione seksuale
- kur i kërkohet një fëmije foto nudo/intime e tyre
- dërgimi i materialeve nudo/intime ose pornografike një fëmije
- vendosja e një fëmije të veprojnë në mënyrë seksuale para një kamere
- bindja e një fëmije që të pranojë të takohet online ose në jetën reale

ÇFARË DUHET TË BËJ NËSE FËMIJA IM KA PËRJETUAR ABUZIM SEKSUAL?

Të mësosh se fëmija juaj ka përjetuar abuzim seksual është alarmante dhe mund të shkaktojë një krizë të madhe brenda familjes. Në fillim, mund ta keni të vështirë të besoni ose të kuptoni se çfarë ka ndodhur në të vërtetë. Lajmi është shpesh një tronditje e madhe për prindërit/kujdestarët ligjorë, pasi në shumicën e rasteve nuk ka patur tregues të qartë për t'i paralajmëruar ata për atë që po ndodhte.

Shumë prindër/kujdestarë ligjorë raportojnë se kanë përjetuar një sërë emocioneve pas marrjes së informacionit fillestar. Është e natyrshme që, si prindër, të jeni të hutuar dhe të përjetoni ndjenja si mosbesimi, trishtimi, zemërimi, frika, me të cilat duhet të përballeni ju dhe fëmija juaj, si dhe e gjithë familja. Fëmija juaj gjithashtu mund të shfaqë shumë sjellje kontradiktore dhe të jetë plot me emocione konfuzie, në një moment të zemëruar dhe në momentin tjetër të tërhequr dhe të shqetësuar, gjë që mund të rrisë ndjenjën e pasigurisë dhe pafuqisë së prindërve.

Si prind, ju keni një rol të rëndësishëm në procesin e rikuperimit të fëmijës dhe forcimin e aftësisë së tij për t'u përshtatur dhe për të përballuar vështirësitë të cilat do ketë përpara. Një nga hapat më të dobishëm që mund të ndërmerreni, është të siguroni stabilitet dhe rehati emocionale dhe fizike. Më e rëndësishmja, qëndroni të qetë, besojini fëmijës tuaj dhe jepini atij sigurinë që i nevojitet. Ndërkohë, është gjithashtu e rëndësishme të kujdeseni për veten. Kjo është mënyra e vetme që ju mund t'i siguroni fëmijës tuaj një mjedis qetësues, mbështetës dhe të sigurt për të cilin kanë nevojë.

TË FLASËSH ME FËMIJËN TEND PËR SEKSUALITETIN

Seksualiteti është një pjesë e natyrshme e zhvillimit njerëzor. Seksualiteti zhvillohet që në moshë të re, ndaj fëmijët tuaj mund të kenë pyetje në lidhje me seksualitetin, trupin e tyre dhe pëlqimin ose mospëlqimin e dikujt ose diçkaje apo edhe mbi seksin. Fëmijët e vegjël u qasen gjërave të reja me kuriozitet dhe çështjet që lidhen me seksualitetin rrallë perceptohen nga fëmija si të sikletshme ose të vështira. Prandaj, është e rëndësishme të filloni të flisni herët për këto tema. Nga ana tjetër, nëse fëmija ka njohuri të mira bazë për një çështje, ai është më i pajisur me aftësi për të vlerësuar në mënyrë kritike çdo informacion që i jepet.

Qëllimi i edukimit seksual është që t'i ofrojë informacion fëmijës dhe të promovojë zhvillimin e tij pozitiv seksual dhe mirëqenien e përgjithshme. Edukimi seksual mund të forcojë gjithashtu njohuritë e fëmijës për veten dhe vetëvlerësimin.

Ofrimi i edukimit seksual është përgjegjësi e prindit/kujdestarit ligjor. Është më e lehtë të flasësh për seksualitetin me fëmijët nëse bisedat fillohen herët, janë të lirshme dhe të shpeshta. Ato duhet të jenë pjesë e jetës së përditshme brenda dinamikave familjare, jo në formën e një leksioni, apo diçka që duhet bërë veçmas. Tregohuni të hapur dhe jepni sa më shumë informacion që është i përshtatshëm për moshën dhe nivelin e tyre të zhvillimit.

Edukimi seksual përfshin temat e mëposhtme:



Ju mund të flisni me fëmijën për të gjitha këto çështje.

E DREJTA
PËR EDUKIM
SEKSUAL

Është mirë të dimë!

- Mund të jetë e vështirë të flitet për seksualitetin nëse ndiheni jo rehat mbi çështjen, por shmangia e bisedës nuk do t'i ndalojë fëmijët të marrin informacion mbi seksualitetin ose t'i mbajë të sigurt.
- Praktikoni paraprakisht: Çfarë dëshironi të dijë fëmija juaj dhe si e shprehni atë me fjalë?
- Fëmija juaj mund të pyesë diçka që ju bën të ndiheni jo rehat, ose nuk jeni të sigurt se si të përgjigjeni. Në këtë rast i thoni fëmijës se nuk dini si të përgjigjeni, por do ta bisedoni sërisht këtë çështje.
- Nëse fëmija juaj duket se nuk është fare i interesuar ose në siklet, shtyjeni bisedën një herë tjetër ose ndryshoni kontekstin. Provoni një dalje me biçikletë ose një shëtitje. Përdorni një situatë në një film që po shikoni së bashku, tekstin e një kënge ose një histori nga një libër. Bëjini me dije fëmijës suaj se nëse ai nuk dëshiron të flasë tani, ju jeni gjithmonë aty për të folur kur ai të jetë gati.



Meqenëse tema mund të jetë e vështirë për t'u diskutuar, është e rëndësishme për ju si prind/kujdestar ligjor që së pari të mendoni për perceptimet tuaja në lidhje me seksualitetin. Kjo mund ta bëjë më të lehtë fillimin e një bisede me një fëmijë. Mundohuni ta nisni këtë rrugëtim duke iu përgjigjur pyetjeve më poshtë, në mënyrë që të përpunoni perceptimet tuaja mbi seksualitetin:

- Çfarë paragjykimesh keni në lidhje me seksualitetin?
- Çfarë lloj edukimi seksual keni marrë si fëmijë?
- Çfarë lloj edukimi seksual do të dëshironit të merrte fëmija juaj?

SI MUNDET NJË PRIND/KUJDESTAR LIGJOR TA MBROJË FËMIJËN E TIJ NGA ABUZIMI SEKSUAL?

Fëmijët mund të përballen me dhunë seksuale në ambiente të ndryshme. Në internet kjo mund të nënkuptojë, për shembull, që një i rritur i dërgon një fëmijë mesazhe sugjeruese seksuale ose i kërkon fëmijës një foto nudo. Si prind/kujdestar ligjor, është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm për këtë, në mënyrë që të mund të mbështesni rritjen dhe zhvillimin e sigurt të fëmijës duke i dhënë fëmijës tuaj informacion dhe duke e mbështetur nëse ai ndeshet me këtë lloj dhune.

Të biesh viktimë e abuzimit seksual ose "afritetit-manipulues" (grooming) mund të ndikojë tek fëmija në mënyra të ndryshme. Fëmijët mund të mos e kuptojnë se për shembull marrja e një imazhi nudo ose materiali pornografik nga një i rritur është abuzim seksual. Këto dukuri rrezikojnë të "normalizohen" sepse mund tu ndodhin shpesh vetë fëmijës ose miqve të tyre. Në disa raste, fëmijët mund të mendojnë se përvoja nuk ka pasur ndonjë pasojë të veçantë. Megjithatë, disa fëmijë mund të ndihen të shqetësuar, të dëshpëruar, vetëkritikë, të turpëruar, të frikësuar ose të vetëfajësohen për incidentin. Disa fëmijë mund të përjetojnë simptoma somatike si: dhimbje koke, dhimbje stomaku ose vështirësi për të fjetur.

Shumica e fëmijëve u tregojnë vetëm shokëve të besuar atë që ka ndodhur dhe nuk flasin me prindërit e tyre. Kjo është arsyeja pse është shumë e rëndësishme që ju të jeni të vetëdijshëm për çdo ndryshim në sjelljen e fëmijës suaj dhe të jeni në dispozicion për ta mbështetur fëmijën në nevojë. Çdo ndjenjë e fëmijës suaj është e vlefshme dhe është e rëndësishme t'i kujtoni fëmijës se nuk është kurrë faji i tij nëse ka rënë viktimë e abuzimit seksual, edhe nëse ka qenë aktiv në situatë – është gjithmonë përgjegjësi e të rriturit që e ka nënshtruar ndaj abuzimit.



Është mirë të dimë!

Ka disa faktorë parandalues që mund të zvogëlojnë rrezikun që një fëmijë të bjerë viktimë e abuzimit seksual. Këto përfshijnë krijimin e një mjedisi të sigurt për fëmijën dhe ofrimi i mbështetjes për të cilën ka nevojë. Ju duhet të synoni të keni marrëdhënie të mira dhe të hapura me fëmijën tuaj, në mënyrë që ai/ajo të ndihet rehat dhe t'ju flasë për çdo gjë që mendon. Ndjenja e vetëvlerësimit tek fëmija ndihmon që ata të vendosin kufinj dhe të mos lejojnë dikë tjetër t'i shkeli ato. Të qenit i informuar dhe i edukuar për rreziqet e mundshme mund ta ndihmojë fëmijën të vërejë shenja të bisedave ose situatave që mund të jenë të dëmshme.

E DREJTA
PËR SHËNDET
TË MIRË



Kur i flisni një fëmijë për abuzimin seksual, është e rëndësishme të jeni të hapur, por të flisni në një mënyrë që fëmija ta kuptojë. Ju mund të përdorni një nga mënyrat e mëposhtme për të filluar bisedën:

- A e di se askush nuk duhet të të prekë trupin pa lejen tënde?
- Gjithmonë mund t'i thuash Jo diçkaje që nuk dëshiron ta bësh - ti je vetë zot për trupin tënd.
- Nëse ndodh diçka që të bën të ndihesh jo rehat, keq apo që nuk e kupton, të lutem më trego gjithmonë ose fol me një të rritur tjetër të besuar (psh prindi tjetër, gjyshërit apo halla/daja/teze etj)

ZHVILLIMI SEKSUAL I FËMIJËVE

E DREJTA
PËR ZHVILLIM
TË SHËNDETSHËM

Zhvillimi seksual i një fëmije ndodh në faza dhe është një pjesë e natyrshme dhe e pritshme e rritjes dhe zhvillimit të tyre të përgjithshëm. Disa sjellje dhe shprehje të seksualitetit të një fëmije mund t'ju befasojnë, ose shqetësojnë ju, një prind/kujdestar. Kjo është arsyeja pse është mirë të jemi të vetëdijshëm për zhvillimin e seksualitetit të një fëmije dhe si mund të manifestohet në sjelljen e fëmijëve.

Tabela e mëposhtme përshkruan zhvillimin seksual të fëmijës dhe mënyrën se si seksualiteti shfaqet në sjelljen e fëmijës. Gjërat e paraqitura në tabelë përshkruajnë zhvillimin seksual të fëmijës në një nivel të përgjithshëm. Megjithatë, është e rëndësishme të mbani mend se çdo fëmijë rritet dhe zhvillohet me ritmin e vet.

Është mirë të dimë!

Fëmijët kanë nevojë për një mjedis të hapur dhe jo-gjykses për të eksploruar dhe mësuar rreth seksualitetit të tyre. Seksualiteti është pjesë e pandashme e zhvillimit dhe ju si prind/kujdestar ligjor mund ta ndihmoni fëmijën tuaj të pranojë trupin dhe seksualitetin e tij në mënyrë funksionale dhe të shëndetshme. Ndiqni zhvillimin e seksualitetit të fëmijës suaj, inkurajoni ata të shprehin nevojat e tyre, kënaqin kureshtjen e tyre dhe bëhuni një burim i informacionit të saktë dhe të përshtatshëm për moshën.

Mos harroni të:

- Krijoni një mjedis ku fëmijët ndihen të sigurt dhe rehat për seksualitetin e tyre.
- Mbështesni dhe ndërtoni një mjedis në të cilin fëmija mund të shprehë seksualitetin pa u gjykuar, ndëshkuar apo tallur.
- Flisni hapur me fëmijën për të gjitha aspektet e seksualitetit në një mënyrë që ai mund ta kuptojë.
- Jini të gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre dhe për të dhënë informacion të saktë.
- Respektoni privatësinë dhe kufijtë e fëmijëve, duke u siguruar që ata të kenë kontroll mbi trupin dhe zgjedhjet e tyre.
- Krijoni besim dhe respekt të ndërsjellë, duke ofruar udhëzime pa qenë tepër ndërhyrës.

Fazat e zhvillimit seksual dhe sjelljes së fëmijëve:

0-3 vjeç:

Foshnjat përjetojnë ndjesi të këndshme dhe të pakëndshme fizike që lidhen me trupin e tyre, por sjellja seksuale siç kuptohet zakonisht nuk ndodh.

Gjatë fëmijërisë, fëmijët zhvillojnë një kuptim bazë të trupit të tyre përmes prekjes dhe eksplorimit.

4-7 vjeç:

Fëmijët fillojnë të zhvillojnë një ndjenjë të identitetit të tyre gjinor dhe bëhen më të vetëdijshëm për dallimet fizike midis gjinive dhe midis seksit biologjik dhe gjinisë.

Ata mund të shprehin kuriozitet për pjesët e trupit dhe të angazhohen në eksplorimin e trupit dhe organeve të tyre gjinitale. Ata fillojnë të zhvillojnë një ndjenjë modestie dhe privatësie.

8-11 vjeç:

Ndërsa fëmijët hyjnë në këtë fazë, kurioziteti i tyre për trupin dhe seksualitetin mund të rritet.

Ata mund të fillojnë të bëjnë pyetje rreth riprodhimit, marrëdhënieve ose të përfshihen në lojëra imagjinare që lidhen me romancën ose familjen.

12-14 vjeç:

Puberteti shënon një fazë të rëndësishme të zhvillimit seksual. Ndryshimet hormonale çojnë në ndryshime fizike në trup, duke përfshirë zhvillimin e karakteristikave sekondare seksuale si zhvillimi i gjirit tek vajzat dhe rritja e testikujve tek djemtë.

Gjatë pubertetit, fëmijët mund të përjetojnë ndjenja dhe tërheqje seksuale ndaj të tjerëve, si dhe rritje të interesit për temat që lidhen me seksin dhe marrëdhëniet.

NDIHMONI FËMIJËN TUAJ TË JETË I SIGURT NË INTERNET


Në përgjithësi, është mirë që interneti dhe rrjetet sociale të konsiderohen si një vend i mirë dhe i sigurt për fëmijët. Fëmijët përdorin internetin p.sh., për aktivitete shkollore, hobi, lojëra dhe për t'u shoqëruar me miqtë. Në rastin më të mirë, mjedisi dixhital mbështet zhvillimin e fëmijës, rrit njohuritë, aftësitë dhe mirëqenien e tyre. Megjithatë, është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm për rreziqet e përdorimit të internetit. Jo të gjitha përmbajtjet janë të destinuara për fëmijë dhe ata mund të hasin për shembull ngacmim kibernetik, gjuhë urrejtjeje apo përmbajtje të dhunshme ose seksuale në internet.

Të rritur që u kërkojnë fëmijëve të dërgojnë imazhe nudo të tyre

Është pjesë e përditshmërisë së fëmijëve që të bëjnë imazhe dhe video të tyre dhe t'i dërgojnë ato te miqtë ose t'i postojnë në llogaritë e tyre të mediave sociale me shumë pak limite. Këtë e bëjnë edhe fëmijët e vegjël. Ndarja e imazheve është një mënyrë për t'u shoqëruar, për t'u argëtuar dhe një mënyrë e thjeshtë për të komunikuar me bashkëmoshatarët. Megjithatë, fëmijëve mund t'u kërkohet, nga një bashkëmoshatar, një i njohur i rritur ose një i panjohur, të bëjnë imazhe ose video nudo ose intime të tyre dhe t'i ndajnë ato në internet. Kur bëhet fjalë për fëmijët e vegjël (5-11 vjeç), ata nuk duhet t'i ndajnë me askënd imazhet intime të tyre. Nëse një i rritur i kërkon një fëmije të dërgojë një imazh nudo ose intim të tij, kjo përbën vepër penale.

Nëse fëmija i dërgon një imazh nudo/intim të vetes një të rrituri që e ka kërkuar dicka të tillë, është gjithmonë përgjegjësi e personit që e kërkon.

Fëmijët e vegjël duhet të udhëzohen që të mos ndajnë kurrë imazhe nudo ose intime të tyre me një bashkëmoshatar, një të njohur ose një të huaj. Pasi një imazh dërgohet ose postohet, ai mund të përhapet në internet pa patur asnjë kontroll mbi të. Është një pjesë e natyrshme e zhvillimit seksual të një fëmije që të intrigohet nga trupi dhe lakuriqësia e vet dhe e të tjerëve. Fëmijët mund të mendojnë se është në rregull të dërgojnë një imazh nudo/intim vetjak nëse dikush e kërkon - mund të jetë e frikshme, por edhe emocionuese. Fëmijët e vegjël mund të mos kenë ende të kuptuarin, njohuritë, aftësitë për të vlerësuar këto lloj kërkesash.



Është mirë të dimë!

Fëmijët kanë nevojë për informacion, mbështetje, mbrojtje por edhe kufij për të qenë të sigurt në internet. Informacioni ndihmon në mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet. Është detyrë e prindit/kujdestarit ligjor që t'i udhëzojë fëmijët të lundrojnë në mënyrë të sigurt në internet. Nëse fëmija juaj ndihet i sigurt dhe ka një marrëdhënie besimi me ju, ka më shumë gjasa që ai t'ju tregojë për përvojën në internet që e shqetëson, e dëmton ose e tremb. Mos harroni të jeni aty për fëmijën tuaj.

Si mundeni ju si prind/kujdestar ligjor të mbështesni dhe mbroni fëmijën tuaj që të jetë i sigurt në internet?

- Jini të pranishëm dhe të interesuar për aktivitetin e fëmijës tuaj në internet. Nxisni një mjedis të sigurt dhe të hapur ku fëmijët ndihen rehat të diskutojnë mbi aktivitetin e tyre në internet. Nxitini ata të tregojnë për çdo gjë që mund t'i ketë bërë ata të ndihen jo mire ose të pasigurt.
- Filloni bisedën për sigurinë në internet dhe ndarjen e imazheve/videove sapo fëmija juaj të fillojë të përdorë pajisjet dixhitale. Ndonjëherë prindërit mendojnë se fëmijët e tyre janë shumë të vegjël për të filluar bisedën, por shpesh nuk është kështu.
- Flisni hapur dhe në mënyrë të përshtatshme për fëmijët për rreziqet ekzistuese që janë të pranishme në internet. Tregojini fëmijës se nuk duhet të ndajë foto nudo ose intime në internet.
- Vendosni kufinj. Vendosni rregulla të qarta për kohën para ekranit dhe përmbajtjen e duhur. Inkurajoni një ekuilibër të shëndetshëm midis aktiviteteve në internet dhe formave të tjera të organizimit të kohës së lirë.

MBROJTJA E PRIVATËSISË NË INTERNET TË FËMIJËS SUAJ

Fëmijët e sotëm lindin në një epokë dixhitale dhe përshkruhen si "të lindurit dixhital". Si ndikon kjo në privatësinë dhe zhvillimin e fëmijëve?

Privatësia është jetike për zhvillimin e ekuilibruar të fëmijëve. Privatësia në internet është një fenomen social i kohëve të fundit që edhe të rriturit e kanë të vështirë ta kuptojnë. Fëmijët perceptohen veçanërisht të cenueshëm ndaj kërcënimeve të privatësisë në internet për shkak të mungesës së aftësive dixhitale dhe ndërgjegjësimit për rreziqet ndaj privatësisë. Rreziqet në internet, të tilla si abuzimi seksual, mund të kufizojnë zhvillimin harmonik të fëmijës në fëmijëri, adoleshencë dhe moshë madhore. Prandaj është e rëndësishme që ne të njohim dhe respektojmë të drejtën e fëmijëve për të qenë aktivë në internet por duke ruajtur gjithashtu privatësinë e tyre.



Udhëhiq duke qenë shembull: Reflekto për atë që ti poston në internet për fëmijën tënd

Ju gjithashtu duhet të reflektoni mbi sjelljen tuaj në internet, veçanërisht atë që prek fëmijën tuaj. Për shembull, duhet të rishikoni tendencën e fundit dixhitale të "ndarjes", d.m.th., transmetimin e detajeve private (imazhe, video, informacione) për një fëmijë nëpërmjet kanaleve dixhitale nga një i rritur i afërm i fëmijës. Duke zhvilluar një gjurmë dixhitale që në moshë të re, fëmijët mund të brendësojnë

presionin për të performuar vazhdimisht dhe të kërkojnë konfirmim përmes mediave sociale, gjë që mund të ndikojë negativisht në vetëvlerësimin e tyre më vonë në jetë. Prindërit duhet të jenë të vetëdijshëm për motivet e tyre kur angazhohen në postime, duke i dhënë përparësi mirëqenies së fëmijëve të tyre përkundrejt vetëpromovimit.

Është mirë të dimë!

• Edukoni fëmijën tuaj për përdorimin e internetit dhe privatësinë

Fëmijët duhet të jenë të vetëdijshëm për ndikimin që mund të ketë aktiviteti i tyre në internet si tek ata, ashtu edhe tek njerëzit e tjerë. Edhe fëmijët më të rritur luftojnë për të kuptuar kompleksitetin e internetit dhe shumëllojshmërinë e rreziqeve në internet. Prandaj, është e rëndësishme t'i informoni fëmijët tuaj se:

- Në momentin kur postojnë përmbajtje në internet, ata nuk kanë më kontroll mbi të. Mund të përcillet, ruhet ose printohet. Gjithashtu, fshirja e një imazhi ose videoje nga interneti nuk do të thotë domosdoshmërisht se është zhdukur. Prandaj, ata duhet të mendohen me kujdes përpara se të postojnë ndonjë përmbajtje të tyre në internet dhe gjithmonë të kërkojnë leje përpara se të postojnë ndonjë përmbajtje të tjerëve në internet.
- Ata duhet t'i mbajnë private të dhënat e tyre personale (p.sh. numrin e telefonit, adresën e shtëpisë, shkollën apo vendndodhje tjetër) dhe të mos i ndajnë ato me të huajt. Bëjini të vetëdijshëm se disa njerëz fshihen pas profileve false.
- Ata duhet të përdorin fjalëkalime të forta për çdo llogari në internet dhe të mos i ndajnë ato me të tjerët.
- Informacionet që gjejnë në internet mund të jenë të papërshtatshme për moshën e tyre dhe jo të besueshme. Nxitini ata të jenë kritikë për atë që shohin në internet.

• Menaxhoni përmbajtjen në të cilën fëmijët mund të kenë qasje dhe nxisni komunikimin e hapur

Kontrolli prindëror dhe konfigurimet e privatësisë në aplikacionet, pajisjet dhe llogaritë e fëmijëve janë mjete mjaft të dobishme për të minimizuar rreziqet në internet. Por mbani mend se këto janë vetëm një pjesë e sigurisë në internet. Sigurohuni që të vazhdoni të bëni biseda të rregullta me fëmijët tuaj për përvojat e tyre në internet dhe inkurajoni ata të ndajnë çdo gjë që mund t'u duket e pakëndshme ose e pasigurt. Gjithashtu, mbani mend se nuk është mirë të shihni gjithçka që fëmija po bën në internet ose vendndodhjen e tij pa një arsye të mirë, pasi ky është gjithashtu një aspekt i të drejtës së fëmijës për privatësi.



BISEDË KU NJË I RRRITUR I PANJOHUR KËRKON NJË IMAZH NUDO



Ka disa shenja alarmi në bisedë që mund t'i mësoni fëmijës tuaj tu kushtojë vëmendje:

- Nëse dikush kërkon ta mbajë të fshehtë bisedën nga të tjerët ose po dërgon vazhdimisht mesazhe
- Nëse dikush kërkon të marrë informacion personal
- Nëse dikush kërkon imazhe nudo/intime ose dërgon imazhe të tilla të vetvetes
- Nëse dikush dërgon mesazhe sugjeruese seksuale ose pyet për përvojat e mëparshme seksuale

Në këto raste, është e rëndësishme që fëmija të ndalojë së shkëmbyeri mesazhe me personin, ta bllokojë atë në të gjitha platformat dhe t'i tregojë një të rrituri të besuar. Pamjet e ekranit duhet të merren nga biseda pasi ato mund të përdoren si provë. Situata duhet të raportohet në polici.

DY SHTATËVJEÇARË BËJNË FOTO TË ORGANEVE TË TYRE GJENITALE DHE PJESËVE TË TJERA TË TRUPIT



Kur diskutoni mbi ndodhinë me fëmijën tuaj, mbani parasysh sa më poshtë

- Flisni hapur me fëmijët për atë që ka ndodhur, është e rëndësishme që ata të mos ndihen të turpëruar dhe të vënë në siklet mbi nevojën për të njohur trupat e fëmijëve të tjerë;
- Shpjegojuni fëmijëve se nuk është në rregull të postojnë fotot e tyre nudo/intime në internet ose në rrjetet sociale, sepse pasi të postohen fotot, nuk ka më kontroll mbi to.
- Pranoni se është një kuriozitet normal dhe se është pjesë e zhvillimit seksual të fëmijës.

JU VINI RE SE FËMIJA JUAJ PO SHIKON NJË VIDEO PORNOGRAFIKE NË KOMPUTERIN E TIJ DHE NDËRSA AFROHENI, AI NDRYSHON FAQEN.

- Ruani qetësinë. Nëse keni nevojë të mendoni se si ta adresoni këtë situatë, merrni kohën tuaj.
- Gjeni një hapësirë dhe kohë të qetë më vonë për t'iu kthyer temës. Pyeteni fëmijën tuaj për atë që po shikonte në mënyrë të lirshme, pa zemërim apo gjykim në tonin tuaj.
- Diskutoni pornografinë në terma informativë. Tregojini fëmijës se është normale të interesohet për seksualitetin dhe seksin. Është e rëndësishme të kuptohet se pornografia është aktrim: të rriturit përfshihen në aktivitet seksual me njëri-tjetrin dhe filmohen. Pornografia nuk pasqyron domosdoshmërisht realitetin. Gjithashtu, pornografia mund të ndikojë në perceptimin e tyre për seksin në të ardhmen.
- Së bashku kërkoni për informacion të besueshëm për seksualitetin online apo në bibliotekë.



KUJDESU TË QËNDROSH PRANË FËMIJËS TËNË

Projekti **CSAPE** synon të parandalojë abuzimin seksual të fëmijëve përmes promovimit të edukimit seksual dhe mbështetjes për adoleshentët që kanë një interes seksual tek fëmijët. Projekti **CSAPE** zbatohet në bashkëpunim mes **Save the Children Finlande, Save the Children Shqipëri, Save the Children Ballkani Veri Perendimor, KMOP - Aksioni Social** dhe **Qendra për Inovacion në Greqi dhe Barnaheill - Save the Children Islandë**.



Funded by
the European Union

Financuar nga Bashkimi Europian. Këndvështrimet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorit (autorëve) dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të Bashkimit Europian. As Bashkimi Europian, as autoriteti i financues nuk mbajnë përgjegjësi për to.



CHILD SEXUAL
ABUSE PREVENTION
AND EDUCATION